



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:074467

Datë: 29.04.2019

Numri i dokumentit: 00293623

P.nr.122/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit A. A.. nga fshati L..., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.119/2019, të datës 25.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 18.04.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A... A..., nga babai N... dhe nëna N..., e lindur L..., i lindur me datë..., në fshatin..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i punësuar në furrën “...”, në Gj..., i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 10.01.2019, rreth orës 21:30 minuta, në Gj..., në rrugën “.....” me paramendim, pa autorizim ka poseduar substancë psiktotropike–...në sasi prejçka edhe është vërtetuar me rastin e ndalimit të veturës së markës “...”, me tabela të regjistrimit....., të cilin e drejtonte i pandehuri, ku me rastin e kontrollimit nga ana e policëve i është gjetur sasia esë lartcekur dhe e njejta i është konfiskuar.

-Me çka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-ës.

Andaj, në bazë të neneve 4,41,42,43,46,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehurit i shqiptohet:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit A... A..., i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej nga 300 € (treqind) euro, të cilën do ta paguajë në afat prej 15 ditëve, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të llogaritet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2 pika 2.7, nenit 69 dhe nenit 275 paragrafi 3 të KPRK-së, të pandehurit të lartcekur i shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që nga i pandehuri..., KONFISKOHET substanca narkotike e llojit “.....”, në peshë prej....., e cila pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t’ia bashkangjesin lëndës përkatëse.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetë e pesë euro), në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.01.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 119/19, ndaj të pandehurit ...për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës.

Me datë 18.04.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit dhe i pandehuriku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj me ç’rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehurika kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 i KPRK-ës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilën do ta paguajë në afat prej 15 ditëve, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij duke pasur parasysh edhe faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, po ashtu gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njëjti bie ndesh ligjin, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mori parasysh edhe gjendjen pasurore të të pandehurit ku edhe përkundër deklaramit të tij senënkupton se ai realizon të hyra vetanake dhe me këtë lloj dhe lartësi të dënimit të njëjtit nuk i cënohet mirëqenia e tij por as e familjes së tij ndërsa si rrethanë rënduese gjykata parasysh faktin se dukuria e përdorimit të substancave narkotike në shoqërinë tone e sidomos tek të rinjtë është bërë dukuri e shpeshtë andaj gjykata konsideron dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

5.Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësues

Gjykata duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7, dhe nenin 275 paragrafi 3 të KPRK-ës, të pandehurit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues dhe atë konfiskimin me të cilin vendim ka konfiskuar substancën narkotike të llojit “Marihuanë”, në sasi prej 0.8 gram të cilën e posedonte i pandehuri....., e cila pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t’ia bashkangjesin lëndës përkatëse.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetepesë euro), në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.122/2019, me datë 18.04.2019

Procesmbajtësja,
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.